

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Naim Mehulli**, në çështjen juridike të paditësit: Departamenti I Administratës Pensionale të Kosovës të cilën e përfaqëson nga Ministria e Drejtësisë- Divizioni për përfaqësim Gjyqësorë kundër të paditurës: rreza Mitrovica, baza e kontestit: Pasurim I Pa Bazë, pas mbajtjes së seances kryesore të datës: 07.07.2016 me datën 18.07.2016 bie këtë:

AKT GJYKIM

I. APROVOHET PJESERISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Departamenti I Administratës Pensionale të Kosovës.

II. OBLIGOHET i paditura nga Mitrovica që t'ia kthej paditëses: Departamentit të Administratës Pensionale shumën prej 60 euro në emër të pasurimit të pabazë në llogarinë rrjedhëse nr. 1 të 1

III. OBLIGOHET i Padituri që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë paditëse shumën prej 15 euro, në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit ne shumë prej 60 euro REFUZOHET SI E PA BAZUAR

Arsyetim

Paditësja me datë: 02.06.2015 ka parashtruar në gjykatë padi për kthimin e mjeteve të cilat i ka tërhequr e paditura si pasurim I pa bazë.

Përfaqësuesi i paditëses në Shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke konsideruar se është provuar me prova se e paditura i ka tërhequr ato mjete pa bazë si dhe i kërkoj shpenzimet procedurale.

E paditura në shqyrtimin kryesor dhe ne fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoj pjesërisht padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, pasi që nëna ime ka vdekur me datën 30.12.2013, kjo vërtetohet me se miri ne baze te certifikatës se vdekjes, ku për muajin dhjetor i ka takuar pensioni, ndërsa pensioni për muajin Janar 2014 nuk e kontestojmë, pasi që ky pension është tërhequr pa qellim që te përfitojmë ne rastin ne fjale.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në seancën kryesore administroi këto prova: regjistri për kthimin e mjeteve financiare, njoftimi i zyrës kryesore se APK për vdekjen konfirmuar, njoftimi i raiffeisen bankë për tërheqjen e te hollave te dt. 14.05.2015, marreveshja mbi hapjen e llogarisë individuale dhe kartelës e dt. 26.09.2006, kopja e letër njoftimit për te paditurën,

marrëveshja pa date nënshkrim dhe vule, kontrata mbi hapjen e llogarisë bankare për të ndjerën ... e dt. 16.09.2002, kontrata për hapjen e llogarisë e dt. 25.11.2002, deklarata për burime dhe origjinën e fondeve të saj të ndjerës e dt. 25.11.2002, kopja e letërnjoftimit për të ndjerën ... dhe burrit të saj të ndjerin ... flet tërheqja nga banka raiffeisen bankë e dt. 24.01.2013, pasqyra e llogarisë bankare të cilën e paditura e ka sjellë në Gjykatë në seance ku shihet se pensionet janë tërhequr për muajin 09.2013, 10.2013, 11.2013, ndërsa nuk ka tërhequr për muajin 12, por ka bërë tërheqje prej 120 euro në muajin Janar 2014, certifikata e vdekjes e dt. 07.07.2016.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së, dhe pas vlerësimit të lirë të tyre arriti në përfundim:

Për Gjykatën nuk është kontestuese se e paditura ka pas autorizim për tërheqje të hollave për prindin e saj- nënën, pasi që nga historiku i pagesës vërtetohet se deri me datën 24.01.2014 janë tërheq parët nga llogaria e ...

Sa i përket datës së vdekjes së të ndjerës ... gjykata ia fali besimin certifikatës së vdekjes si dokument publik i lëshuar nga autoriteti përkatës, i cili kur vlerësohet në raport me shënimin e të paditurës për gjykatën është provë më e besueshme.

Nuk është kontestuese se e paditura i ka tërhequr shumën prej 120 euro në emër të ndjerës ... një muaj pasi e njëjta ka vdekur, e që një gjë e tillë është në kundërshtim me nenin 2 par.4 dhe nenin par.5 të udhëzimit administrative 14/2009 për ndalesën e pagesave të pensionit bazë.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë, gjykata nuk e aprovoi në lartësinë e lartcekur në padi, pasi që gjykata ka konstatuar se e paditura vetëm shumën prej 60 euro e ka tërhequr të cilat sipas ligjit nuk ka pasur të drejtë t'i tërheq pas vdekjes së prindit të saj, të ndjerës

Gjykata konform nenit 210 paragrafi 1 të LMD-së konsideron se e paditura ka fituar pa bazë, duke bërë tërheqjen e të hollave të cilat sipas ligjit dhe udhëzimit administrative nuk ka pasur të drejtë t'i tërheq pas vdekjes së prindit të tij të ndjerës


Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së dhe nenin 210 të LMD-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.Nr.320/2015 datë: 18.07.2016

GJYQTARI

Naim Meholl



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditor nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë - nëpërmjet kësaj gjykate.